



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo životne sredine, prostornog planiranja i
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Në bazë të Ligjit Nr. 08/L – 197 për zyrtarët publikë, Neni 39 (1,2,3,4,5 dhe 6) dhe Rregullores (QRK) NR. 15/2023 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovë, Neni 5 Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës shpall:

Konkurs

Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Titulli i pozitës së punës	Drejtor i Departamentit të Infrastrukturës Rrugore
Klasa e pozitës	Drejtues i Mesëm
Koeficienti/Paga	8.9
Nr. i kërkuar	1
Kohëzgjatja e emërimit	Me mandat 4 vjeçar
Data e njoftimit	24/03/2025
Afati për aplikim	25/03/2025 - 23/04/2025
Institucioni	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Departamenti	
Divizioni	Departamenti i Infrastrukturës Rrugore dhe Hekurudhore
Vendi i punës	Prishtinë
Nr. i Referencës	RN00017356
Kodi	RPC0010895



1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

- Propozon, harton dhe zhvillon politika në fushën e zhvillimit të infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore;
- Identifikon nevojat dhe fillon procedurat për hartimin e legjislacionit në fushën e zhvillimit të infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore, harton legjislacionin në fjalë, në pajtim me legjislacionin e BE-së dhe standardet ndërkombëtare, dhe siguron zbatimin e tij;
- Harton programet vjetore për ndërtimin, rikonstruktimin dhe mirëmbajtjen e autoudhëve, rrugëve nacionale dhe rajonale si dhe hekurudhave. Identifikon dhe harton nevojat për investime dhe financim në fushën e zhvillimit të infrastrukturës rrugore dhe hekurudhor;
- Ofron mbështetje për çështjet që kanë të bëjnë me anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare nga fusha e zhvillimit të infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore;
- Bashkëpunon me institucionet vendore dhe ndërkombëtare, veprimtaria e të cilave lidhet me në fushën e zhvillimit të infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore;
- Harton raporte periodike dhe sipas kërkesave nga fushë veprimtaria e zhvillimit të infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore;
- Vlerëson dhe ofron komente rreth legjislacionit të sektorëve tjerë si dhe akteve komunale të cilat kanë të bëjnë me fushën e zhvillimit të infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore;
- Mbanë bazën e shënimeve për: Autoudhë, rrugët nacionale dhe rajonale si dhe hekurudhave të Kosovës dhe objekteve strukturore të tyre;
- Harton programet e mbrojtjes së rrugëve nga transporti i jashtëzakonshëm dhe dëmtimi i rrugëve dhe programet e mbrojtjes së mjedisit gjatë ndërtimit dhe shfrytëzimit të rrjetit rrugor të Kosovës;
- Përgatitë, studimet e fizibilitetit, detyrat projektuese, specifikimet teknike për projektet kapitale të lëmisë së infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore, mirëmbajtjes së rrugëve dhe hekurudhave: Mirëmbajtjes së: Autoudhëve, rrugëve nacionale, rrugëve rajonale dhe hekurudhave;
- Menaxhon me e mjetet e ndara nga buxheti për investimet kapitale dhe mirëmbajtjen në infrastrukturën rrugore dhe hekurudhore, në kuadër të kompetencave të veta;
- Koordinon projektet e ndërtimit dhe rikonstruimit të rrugëve me Ministrinë e ndryshme, komunat si dhe agjensionet;
- Harton programet e mbrojtjes së mjedisit gjatë ndërtimit dhe shfrytëzimit të rrjetit rrugor dhe hekurudhor të Kosovës;
- Koordinon aktivitetet e sigurisë së komunikacionit dhe inicion programet për përmirësimin e sigurisë së komunikacionit në rrugët dhe hekurudhat e Kosovës;
- Koordinon punët gjatë hartimeve të projekteve dhe studimeve të ndryshme për rrjetin e rrugëve dhe hekurudhave dhe sigurinë e komunikacionit në rrugët dhe hekurudhat e Kosovës;
- Të gjitha detyrat tjera të përcaktuara në legjislacionin në fuqi që mbulon fushën e infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore.



2.Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë, sipas nenit 9 të LZP-së

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për veprim, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik.
- Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës.
- Të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

a) Arsimimi i kërkuar: Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor).

Fushat: Juridik, Ekonomi (pavarësisht nga specializimi), Inxhinieri e Ndërtimit, Inxhinier Strukturore, Inxhinieri Arkitekturore, Inxhinieri Gjeoteknike, Hidroteknikë.

b) Kërkesat specifike: Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitën e kësaj klase.

c) Përvoja e punës e kërkuar: Së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale duke përfshirë njërën nga kërkesat në vijimin:

c.1.) tre (3) vite përvojë pune në pozita drejtuese, ose

c.2.) dy (2) vite përvojë punë në pozita drejtuese dhe diplomë të nivelit të dytë të arsimit të lartë (master), ose

c.3.) një (1) vit përvojë punë në pozita drejtuese dhe diplomë të nivelit të tretë të arsimit të lartë (doktoraturës).



4. Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit

- Aftësi të larta organizative, drejtuese dhe për hartim politikash.
- Aftësi për t'iu përshtatur prioriteteve dhe kërkesave, afateve kohore përmes aftësive të nivelit të lartë analitik dhe zgjidhjes së problemeve.
- Njohuri të gjëra lidhur me fushën e përgjegjësisë së Departamentit, menaxhimin e buxhetit dhe të shërbimit civil.
- Aftësi komunikimi dhe bashkëpunimi, përfshirë aftësinë për të krijuar dhe mbajtur marrëdhënie mirëbesimi me eprorin dhe stafin që e menaxhon.
- Aftësi për të motivuar stafin dhe për të menaxhuar me sukses projektet e Departamentit.
- Njohja e gjuhëve të huaj (e preferueshme).

5. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre

- Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës/certifikatës së shtetësisë së Republikës së Kosovës.
- Kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs të lëshuar nga institucionet arsimore të Republikës së Kosovës. Nëse diploma është fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar apo aktin që dëshmon se diploma e fituar është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë;
- Kopjet e dëshmisë së punësimit (vërtetim/kontratë) të lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimit në atë pozitë. Dëshmisë e punësimit jashtë institucioneve publike duhet të mbështet së paku njëra nga dëshmitë si në vijim: pasqyra e pagesave në fondin e kursimeve pensionale apo pasqyra e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personal. Përvoja e punës, e cila deklarohet sipas kushteve të konkursit, e fituar në një shtet tjetër, dëshmohet përmes dëshmisë së përkthyer mbi përvojën e punës së lëshuar nga organi kompetent i atij shteti, apo përmes dëshmisë së përkthyer dhe noterizuar të përvojës të lëshuar nga punëdhënësi përkatës.
- Dëshmitë e trajnimeve profesionale të ndjekura apo trajnimeve që aplikuesi i ka realizuar në cilësinë e trajnuesit.
- Kopjet e dokumenteve tjera që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion.

Dëshmitë që nuk kërkohen gjatë aplikimit, por në fazën e verifikimit para emërimit

- Certifikatë mbi dënimet penale origjinale e lëshuar nga gjykata përmes së cilës dëshmohet se nuk është i/e dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje, jo më të vjetër se (6) muaj nga data e lëshimit.
- Dëshmi se kandidati është i aftë në pikëpamje shëndetësore.
- Dëshmi përkatëse se kandidati ka zotësi të plotë për të vepruar.
- Dëshmi që nuk ka në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik (Kandidatët që janë të punësuar apo kanë qenë të punësuar në institucione publike).

6. Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak

- Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për pranim do të shpallet më së largu deri më datën 08/05/2025, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)



7.Kriteret specifike shtesë

8. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Testimi me shkrim – maksimumi 70 pikë
- Intervista – maksimumi 30 pikë

9. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes email dhe portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

10. Mënyra e aplikimit

- Përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

11. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Të dhëna shtesë:

- Pas përzgjedhjes së kandidatit fitues, njësia përgjegjëse bën verifikimin para emërimit me qëllim të vërtetimit se kandidatët vazhdojnë të plotësojnë kriteret e konkursit, përmes dokumenteve në origjinal apo të njësuara me origjinalin.

Komitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuar dhe gjinia më pak e përfaqësuar kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në LZP. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

